

Njoftim për media
2017-07-17 18:27:00



Reagon MSH: Masat që morëm pas denoncimit të kompanisë Euroteam

Më datë 10 korrik 2017, emisioni investigativ “Stop” në Tv Klan ka denoncuar përmes pamjeve filmike, keqadministrimin e mbetjeve spitalore nga kompania e licencuar “Euroteam”. “Stop” ka investiguar rrugën që bënin mbetjet e rrezikshme spitalore dhe derdhjen e tyre në brigjet e lumit Erzen.

Ministri i Shëndetësisë pasi ka përcjellë me shqetësim problematikën e transmetuar, ka kërkuar vënien në dispozicion të një sërë informacionesh nga institucionet përgjegjëse, si Ministria e Mjedisit dhe Inspektorati Shtetëror Shëndetësor.

Menjëherë, autoriteti i Ministrisë së Shëndetësisë, z. Arben Beqiri ka firmosur dy urdhra: Urdhër për “Ngritjen e grupit të inspektimit për subjektet që trajtojnë dhe menaxhojnë mbetjet spitalore” dhe Urdhër për “Ngritjen e grupit të inspektimit për subjektet që prodhojnë mbetjet spitalore”, me qëllim monitorimin e zbatimit të kornizës ligjore nga prodhuesit, trajtuesit dhe menaxhuesit e mbetjeve spitalore.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, pas kërkesës së Ministrit të Shëndetësisë për informacion, ka raportuar një sërë problematikash të evidentuara nga inspektimet e kryera në terren për vitin 2016-2017. Ndërkohë, për shkeljet e konstatuara nga kompanitë e administrimit të mbetjeve spitalore, janë lënë detyra dhe janë marrë masa administrative. Sipas informacionit të përcjellë, në vitin 2015 për kompaninë Euroteam është marrë vendim për mbyllje provizore dhe masë administrative në vlerën 1 000 000 (një milion) lekë për mos administrimin e mbetjeve spitalore sipas legjisllacionit në fuqi.

Ministrisë së Mjedisit, si institucioni që lëshon lejen e veprimtarisë ndaj kompanive për administrimin e mbetjeve spitalore, i është kërkuar të bëjë me dije masën që ka marrë ndaj kompanisë “Euroteam” që prej momentit të

transmetimit të pamjeve nga emisioni "Stop".

Duke njohur ndikimin e drejtpërdrejtë në mjedis dhe në cilësinë e jetës së popullatës, si dhe duke vlerësuar seriozitetin e institucionit të Ministrisë së Mjedisit, që përmes një deklarate për emisionin denoncues informoi pezullimin e aktivitetit të kompanisë "Euroteam", Ministria e Shëndetësisë ka marrë masa duke i kërkuar zyrtarisht Kryeministrisë, më 12.07.2017 "Lejimin e prokurimit për trajtimin e mbetjeve spitalore në disa spitale të vendit". Në kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë citohet qartësisht:

"Nisur nga rëndësia dhe emergjenca që paraqet procesi i trajtimit të mbetjeve spitalore, me qëllim mos ndërprerjen e procesit të trajtimit të mbetjeve spitalore, mbështetur në pikën 2 të Vendimit Nr. 482, datë 05.07.2017, të këshillit të Ministrave "Për pezullimin e përkohshëm të prokurimeve për vitin 2017", kërkojmë miratim për lejimin e spitaleve, për zhvillimin e procedurës së prokurimit për trajtimin e mbetjeve spitalore, për plotësimin e nevojave deri në fund të vitit 2017".

Sot më datë 17.07.2017, Ministri i Mjedisit ka firmosur Urdhrin për revokimin e licencës dhe lejes mjedisore të kompanisë "Euroteam".

Ndërkohë, Kryeministria, duke marrë parasysh kërkesën e paraqitur më herët nga Ministria e Shëndetësisë, ka miratuar lejimin e zhvillimit të procedurës së prokurimit, me objekt "Për trajtimin e mbetjeve spitalore, për plotësimin e nevojave deri në fund të vitit 2017".

Pas fakteve të transmetuara nga gazetarët investigativ dhe pas njohjes me problematikat e raportuara nga Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, Ministri i Shëndetësisë kërkon vlerësimin me seriozitet si dhe korrektësinë e ushtrimit të aktivitetit të kompanive të administrimit të mbetjeve spitalore, nga institucionet kompetente.

Procesi i administrimit të mbetjeve spitalore mund të cilësohet si i prapambetur dhe i shoqëruar me shkelje të vazhdueshme të detyrimeve të sanksionuara me ligj, ndaj duhet ndjekur nga institucionet përgjegjëse deri në hallkën e fundit ku bëhet përpunimi i tyre.